



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/69

Datë: 16.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 tetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Teatrot.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministravo Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

KONCEPT- DOKUMENTI
PËR TEATROT

DRAFT KONCEPT - DOKUMENTI

Kapitulli 1: Hyrje

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Kapitulli 4: Opsionet

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Kapitulli 7: Konsultimi

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)

Kapitulli 9: Rekomandimi

Kapitulli 10: Komunikimi

Kapitulli 1: Hyrje

- Krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për promovimin e kulturës sikurse dhe avancimi i infrastrukturës kulturore me qëllim të krijimit të kushteve adekuate hapësinore, teknike dhe profesionale janë objektiva institucionale dhe njëherazi prioritete afatmesme të parapara dhe në politikat programore si dhe në dokumentet relevante strategjike.

Fusha e kulturës dhe mbështetjes institucionale të saj, paraqitet edhe në kuadër të Vizionit Programor 2017-2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, që kësaj dëshmon për rëndësinë dhe njëherazi përkushtimin institucional për mbështetjen dhe avancimin e sektorit respektiv.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahjes dhe avancimit të sektorit kulturor, ka paraparë një mori masash e objektivash sikurse rishikimi përkatësisht avancimi i kornizës ligjore dhe hartimi i politikave të reja publike që garantojnë pavarësi financiare për institucionet e kulturës dhe menaxhim efikas të përgjegjësi; krijim të politikave të reja kulturore me programe në përkrahje të artistëve dhe nismave kulturore, ristrukturim dhe riorganizim të institucioneve vartëse për kulturë, promovim të kulturës dhe ngritjes së komunikimit kulturor; edukimit; aftësimit dhe pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në këtë kuadër mbetet padyshim edhe mbështetja e institucioneve publike të kulturës e me theks të veçantë kapaciteteve njerëzore e institucionale që mbesin parakusht në avancimin e agjendës institucionale për zhvillimin e kulturës në përmbushjen e misionit dhe fushëveprimit të institucioneve kulturore.

Në këtë drejtim, MKRS në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë tek objektivi *Përkrahja e krijimtarisë kulturore, ndërkombëtarizmi i kulturës* dhe në nën-objektivin *Mbështetja e Institucioneve Publike të Kulturës* përkatësisht Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2018 ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Teatrot si një mundësi e adresimit të çështjeve të listuara përkatësisht definimit normativ e trajtim adekuat të tyre.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Shpjegim

- Teatrot janë institucione elitare dhe të rëndësishme të kulturës skenike dhe të kulturës në përgjithësi edhe për jetën kulturore

në Kosovë.

- Fusha e teatrit aktualisht rregullohet ne baze te ligjit nr. 04/L-106 per Teatrot;
 - Ne vitin 2010 është bërë decentralizimi i përgjigjesive të teatrove publike të qyteteve nëpër komuna perkatese, në baze te nje Memorandumi të nenshkruar nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Kryetareve të komunave.
 - Problemet e identifikuar gjatë zbatimit të ligjit tanimë në fuqi e të evidentuara nga institucionet zbatuese janë te shumta të cilat kanë sjellë probleme të theksuara per teatrot e Kosovës, e me theks te veqante për teatrot e qyteteve te cilat jane ne gjendje aspak te volitshme.
 - Ne Kosovë aktualisht janë këto teatro publike: Teatri Kombëtar i Kosovës, 6 teatro të qyteteve dhe Teatri i Uneversitetit të Prishtinës. Numri i punetoreve te rregullt dhe aktualisht ne kontratë me sherbime të veqanta në keto teatro janë:
 1. Në Teatrin e qytetit të Prizrenit, janë të punësuar gjithesejt 17 veta siç janë: me kontratë të rregullt Drejtori i Përgjithshëm dhe me kontrata njëvjeqare për sherbime te veqanta, 10 aktor dhe 7 punëtor teknik-artistik.
 2. Në Teatrin e qytetit të Gjakovës, janë të punësuar gjithësejt 8 veta siç janë: me kontratë të rregullt Drejtori i Përgjithshëm, 4 aktor dhe 3 teknik-artistikdhe.
 3. Në Teatrin e qytetit të Gjilanit, janë të punësuar gjithshejt 21 vetasiç janë: 12 aktor rezident, 6 teknik rezident, 18 me kontrata në shërbime të veçanta dhe 3 me kontratë të rregullt të punës.
 4. Në Teatrin e qytetit të Mitrovices, janë të punësuar gjithshejt 3 veta me kontratë te rregullt të punës
 5. Në Teatri e qytetit të Ferizait, janë të punësuar gjithshejt 17 veta siç janë: 10 aktor rezident, 3 teknik rezident, 4 me kontratë në shërbime të veçanta, 4 me kontrata te rregullta pune, 1 administratë 3 teknik rezident.
 6. Në Teatrin e qytetit Pejë, janë të punësuar gjithshejt 13 veta siç janë: 8 stafi artistik rezident, 5 teknik rezident
 - Qe pas luftës teatrot publike ballafaqohen me problemin e statusit të tyre juridik dhe financiar, te ansambllit rezident dhe stafit tekniko-profesional;
- Shkaqet e problemit janë:
- definimi jo adekuat i statuteve juridike dhe fiannciar dhe i emertimeve institucionale të teatrove publike te qyteteve.
 - përcaktimi i paqartë i kompetencave mes organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë;
 - interferimi në kompetencat mes organeve të udheheqëse, paqartësia dhe mungesa e përkufizimeve;
 - përcaktimi jo i sakt i obligimeve dhe të drejtave të punonjësve artistik;
 - përcaktimi jo i sakt i numrit të stafit teknik profesional të teatrove;
 - buxheti i paqartë i teatrove të qyteteve;
 - mungesa e bazes ligjore e cila e obligon financimin e tetarove neper komuna;

- mungesa e kodeve të veqanta buxhetore të teatrove publike të qyteteve.

Propozimet për statutet dhe emërtimet institucionale të teatrove në Kosovë:

Teatri Kombëtar i Kosovës (TKK)

- TKK eshte institucion kulturor i rëndësishë së veçant në Republikën e Kosovës;
- TKK është institucion i pavarur;
- Teatri Kombëtar i Kosovës, themelohet nga Kuvendi i Kosovës;
- TKK ka Bordin Profesional dhe Menaxhmentin;
- TKK ka kodin e veçante (PCF 1) vijën e veçante buxhetore.

Teatrot e qyteteve të Kosovës

- Teatrot Kombëtare te qyteteve i themelon Kuvendi Komunal i Qytetit;
- Teatrot Kombëtare të qyteteve janë institucione me rëndësi kulturore për qytetet e Republikës së Kosovës.
- Teatrot Kombëtare të qyteteve janë institucione të pavarura.
- Teatrot e qyteteve kanë Bordin Profesional, dhe Menaxhmentin;
- Teatrot Kombëtare të qyteteve kanë kodin e veçante (PCF 1) buxhetore.

Ri-definimi adekuat i detyrave dhe kompetencave të menaxhmentit të teatrove, në mes të:

- Drejtorit gjeneral dhe dramaturgut, apo
- Itendantit dhe Drejtorit artistik;

Ri-definimi i zgjedhjes se bordit profesional të TKK-së dhe bordeve profesionale të teatrove Kombëtare të qyteteve si me poshtë:

- Autoriteti që e zgjedh dhe menyra e zgjedhjes;
- numri anetareve të bordeve profesionale;
- kriteret apo kushtet që duhen ti plotesoin kandidatet e nominuar për anëtar te bordit profesional;
- kush ka të drejte te nominojë kandidatet per bordet profesionale;
- ri-definimi/percaktimi adekuat i obligimeve dhe te drejtave te punonjesve artistik
- ri-definimi adekuat i detyrave kryesore të bordeve profesionale;
- Ri-definimi adekuat i burimeve financiare të buxhetve të teatrove publike të qyteteve etj;

Politika aktuale

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka për mision hartimin dhe zbatimin krijimin dhe zhvillimin e politikave,

ambientit dhe mekanizme të përshtatshëm për promovimin e aktivitetve të kulturës, promovimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë në qeverisje dhe krijimtari, zhvillimin dhe afirmimin e sportit kosovar në vend dhe në arenën ndërkombëtare si dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

MKRS në fushën e kulturës harton dhe zbaton politika zhvillimore sipas standardeve evropiane, duke e konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin demokratik të vendit dhe për afirmimin e identitetit kulturor të Kosovës brenda identitetit kulturor evropian.

Departamenti i Kulturës krijon mjedis mbështetës për zhvillimin bashkëkohor të arteve skenike-muzikore e pamore, artit të shkruar, botimit të librave si dhe promovimin e saj me aftësi konkurruese në vend dhe në arenën ndërkombëtare; duke promovuar karakterin shumë-etnik në kuadër të proceseve integruese evropiane të një Kosove të pavarur dhe demokratike.

Departamenti i kulturës misionin e vetë synon ta arrijë përmes tri politikave programore të saj si në vijim:

1. **Mbështetja/përkrahja institucionale e kulturës, e Divizionit të Arteve Skenike-Muzikore dhe Pamore;**
2. **Përkrahja e kulturës së pavarur, si dhe avancimi i diplomacisë kulturore, në Divizionin të Promovimit dhe**
3. **Mbështetja e Librit dhe bibliotekave, në Divizionin e Librit dhe bibliotekave.**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë periudhës 2015-2018 në fushën e kulturës ka vazhduar dhe synon të vazhdojë me përkrahjen e institucioneve vartëse të kulturës, përmes investimeve kapitale, plotësimit të infrastrukturës ligjore, subvencionimit të kulturës , promovimit të skenës kulturore në ngjarjet e mëdha të kulturës në Evropë dhe botë.

Politikat aktuale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit zhvillohen bazuar në kornizën aktuale ligjore.

Në fushën e Teatrove është në fuqi Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatrot.

Me këtë Ligj ne veçanti rregullohen çështjet si në vijim:

- Themelimi, vazhdimi i punës dhe i veprimtarisë së Teatrove;
- Rregullimi dhe organizimi;
- Udhëheqja dhe drejtimi i tyre;
- Mjetet për financimin e punës së teatrove dhe shoqatave teatrore dhe
- Çështjet tjera të rëndësishme për veprimtarinë e Teatrove.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet:

- Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatort.
- Ligji i Buxhetit, aktualisht nuk e rregullon qeshijen e financimit, kodit të veqant dhe kategorive të shpenzimeve përkatëse të teatrove të qyteteve.
- Ligji për pushtet lokale i cili e rregullon bartjen e transfereve dhe përgjegjesive tek teatrot e qyteteve.
- Ligji për sponsorizime;

Ligji aktual i teatrove nuk mund të zbatohet sukseshem nga institucionet zbatuese, për asye se me këtë Ligj nuk përcaktohen/rregullohen/definohe sakt, si:

- statutet juridike, financiare dhe i emertimeve institucionale të teatrove publike të qyteteve,
- kompetencat e sakta dhe interferimi i tyre në mes organeve udhëheqëse të teatrove,
- obligimet dhe të drejtat e punonjësve artistik-profesional, dhe numri i tyre në teatro,
- burimi financiar/buxheti e teatrove publike të qyteteve,
- përzgjedhja e anëtarëve adekuat në keshillat drejtues të teatrove,
- baza ligjore e cila e rregullon dhe ju mundëson komunave për financimin e tetarove të qyteteve
- kodet e veqanta buxhetore (PCF 1) për teatrot publike të qyteteve.

Aktet nënligjore

- Statuti i Teatrit Kombëtar i Kosovës;
- Statutet e Teatrove të qyteteve të Kosovës;
- Rregullorja për Këshillin Drejtues të TKK-së
- Rregullorja e MKRS-së për pagesat shtesë të artisteve dhe stafit tekniko-artistik të TKK-së dhe pagesat e të angazhuarve të tjerë në shfaqjeve të TKK-së;

Në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore janë konstituuar dhe funksionalizuar institucionet si: Teatri Kombëtar i Kosovës dhe teatrot e qyteteve të Kosovës.

Programi aktual

- Programi aktual zhvillohet konform Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, dhe politikave afatmesme të MKRS, në kuadër të cilave janë paraparë aktivitete që derivojnë nga Ligji aktual i Teatrove.
- Në Planin e punës për vitin 2018 janë paraparë këto prioritete kryesore:

- Përkrahja e zhvillimit të kulturës dhe krijimtarisë kulturore në Kosovë;
- Ndërkombëtarizimi i kulturës përmes pjesëmarrjes në evenimente ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve kulturore;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe formalizimi i bashkëpunimit kulturor me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e kulturës;
- Avancimi i veprimtarisë kulturore përmes mbështetjes së aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Prioritet e lartpërmendura janë planifikuar të zbatohen përmes Planit Vjetor të Punës të MKRS/DK-së.

Shpenzimet aktuale

- Bazuar në Politikat-programore të Departamentit të Kulturës/MKRS-së të cilat bëjnë mbështetjen institucionale të kulturës.

Lidhur me këtë çdo vit planifikohen dhe ndahen mjete financiare, në kategorinë e subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve, komunalive dhe investimeve kapitale, vetëm për mbështetjen Teatrit Kombëtar të Kosovës

Buxheti i ndarë aktuale për Teatrin Kombëtar të Kosovës, është si në vijim:

Teatri Kombëtar i Kosovës		
Buxheti	Viti	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	368,776.82 €
Subvencione	2018	370,000.00 €
Mallra dhe shërbime	2018	15,800.00 €
Komunali	2018	18,600.00 €
Investime kapitale	2018	/
Buxheti total	2018	773,176.82 €

Teatrot e qyteteve dhe teatrot tjera subvencionohen nga MKRS në bazë të konkurseve vjetore të shpallura sipas Politikave Programore të Departamentit të Kulturës. Prej vitit 2008 e deri ne vitin 2017, Teatrot në vit janë mbështetur deri n 10,000€ dhe

15,000€.

Të bashkangjitur gjeni tabelën e mbështetjes së teatrove ndër vite:

Teatrot	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Teatri I Gjilanit	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri Istref Begolli Peje	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri I Prizrenit	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri I Mitrovices	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri Adriana Abdullahu	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri I Gjakoves	10,000.00	10,000.00	10,000.00	13,000.00	15,000.00	15,000.00
Teatri Oda	15,000.00	10,000.00	10,000.00	15,000.00	16,000.00	15,000.00
Teatri Dodona	10,000.00	10,000.00	10,000.00			
Teatri I Qytetit Vushtrri				6,000.00		8,000.00
Teatri I Qytetit Avdush Hasani Podujeve						
TOTALI	85,000.00	80,000.00	80,000.00	99,000.00	106,000.00	113,000.00

Po ashtu janë përkrahur edhe teatro tjera të qyteteve me të vogla prej 600.00€ deri në 6,000.00€ si: Teatri I Vitisë, Teatri I të Rinjve të Qytetit, Teatri Laborator Loja, Teatri I Fëmijëve Xixëllonjat, Teatri I Ëndrrave Suhareke, Teatri Dukagjini Deçan etj.

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

- Politika aktuale për mbështetjen institucionale të kulturës është hartuar dhe zbatuar nga ana e MKRS-së bazuar në ligjin aktual të Teatrove, dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionin respektive. (*simotra në rajon dhe vendet tjera të BE-së*), si *p.sh.* bashkëpunimi tani e disa vite me Teatrin e Tiranës, në kuadër të bashkëpunimit kulturor në mes të Minsitrisë së Kulturës së Kosovës dhe Shqipërisë, bashkëpunimi me teatrot mbrenda Kosovës, pjesëmarrja në festivalet e kombëtare në Kosovë dhe Shqipëri, dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëta me Maqedoninë, Kroacinë, Bullgarinë, etj

Përvoja në shtetet tjera

- Në funksion të harmonizimit dhe përfrimit me praktikat, standardet dhe përvojat e shteteve të rajonit dhe ato evropiane në fushën e kulturës perkatësisht në fushën e teatrit, janë konsultuar edhe keto përvoja dhe korniza ligjore të këtyre shteteve:

Republika e Kroacisë ka pesë (5) teatro kombëtare: Teatri Kombëtar Kroat Zagreb, Teatri Kombëtar Kroat Osijek, Teatri Kombëtar Kroat Split, Teatri Kombëtar Kroat Rijekë, Teatri Kombëtar Kroat Varazhdin, dhe teatro tjera profesioniste të qyteteve.

Republika e Sllovenisë ka këto teatro kombëtare: Teatri Kombëtar Sloven i Dramës i Lublanës, Teatri Kombëtar Slloven i Operës dhe Baletit i Lublanës, Teatri Kombëtar Slloven i Celjes, Teatri Kombëtar Slloven i Mariborit, Teatri Kombëtar Slloven i Nova Goricës, Teatri Kombëtar Slloven i Kukulave i Lublanës, Teatri Kombëtar i Preshernit i Kranjtit.

Republika e maqedonisë ka nëntë teatro kombëtare: Naroden Teatar Prilep, Naroden Teatar Veles, Naroden Teatar Kumanovo, Naroden Teatar Shtip, Naroden Teatar Bitola, Makendonski Naroden Teatar Skopje, Naroden Teatar Strumica, Teatri Kombëtar Shqiptar Shkup, pastaj teatrot profesioniste si: Teatri i Tetovës, Dramski teatar Skopje, Teatar za Deca i Mladina Skopje, teatro këto që llogariten si interes shtetëror i shtetit maqedon.

Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës ka këto teatro kombëtare: Teatin Kombëtar Boshnjak të Sarajevës, Teatin Kombëtar të Mostarit, Teatin kombëtar boshnjak të Zenicës, Teatin Kombëtar të Banjallukës, Teatin Kombëtar të Tuzillës, Narodno Pozoriste Travnik.

Republika e Serbisë ka këto teatro kombëtare: Teatri Kombëtar Beograd, Teatri Kombëtar Kikinda, Teatri Kombëtar Leskovc, Teatri Kombëtar Subotica, Teatri Kombëtar Nish, Teatri Kombëtar Pirot, Teatri Kombëtar Sombor, Teatri Kombëtar “Sterija” Vrsac, Teatri Kombëtar Leposavic, Teatri Kombëtar Zrenjanin, Teatri Kombëtar Novi Sad, Teatri Kombëtar i Operës Zemun, Pastaj teatrot profesioniste: Teatri “Atelje 212” Beograd, Teatri “Bora Stankovic” Vranjë, Teatri “Bosko Buha” Beograd, Teatri i Kukulave Nish, Teatri i të rinjëve Novi Sad, Teatri “Puls” Lazarevc, Teatri në Terazie Beograd.

Republika e Malit të zi ka këto teatro Kombëtare: Teatri Mbretëror “Zetski Dom” në Cetinje, Teatri Kombëtar Malazec në Podgoricë.

Republika e Shqipërisë ka një teatër kombëtar: Teatri Kombëtar i Shqipërisë në Tiranë, Teatrot e Bashkive dhe teatrot e qyteteve.

Shtetet e rajonit financojnë me të gjitha shpenzimet teatrot kombëtare shtetërore të kryeqyteteve të tyre, teatrot kombëtare rajonale, kurse teatrot kombëtare të qyteteve financohen nga qeveritë shtetërore përkatëse dhe nga qeveritë lokale të qyteteve sipas shumës dhe mënyrës së përcaktuar me ligjet përkatëse.

Shikuar në pëgjithësi, shtetet e rajonit kanë të themeluara, të mbrojtura dhe të financuara me ligjet përkatëse teatrot e tyre kombëtare, qofshin ato të nivelit kombëtar shtetëror, qofshin ato të nivelit kombëtar rajonal apo ato të nivelit kombëtar të qytetit.

- Bazuar në rastin e Kroacisë, përkatësisht organizmit institucional , marrë parasysh këtu dhe harmonizimin e legjislacionit

kroat karshi standardeve dhe praktikave evropiane të fushës, vlerësojmë se legjislatiioni kroat mbetet shembulli më i mirë dhe i përshtatshëm për rrethanat kosovare në kontekst të përditësimit të legjislatiionit në fushën e teatrove, si më poshtë:

Teatrot në Republikën e Kroacisë

Në pajtim me Ligjin ekzistues për teatrot, teatrot në Kroaci veprojnë si teatro publike dhe teatro publike kombëtare dhe të tjera, dhe janë të themeluara si teatro të qytetit, të rajonit, të komunave, pastaj teatro dhe kinema private.

Sipas të gjeturave, në Republikën e Kroacisë veprojnë afërsisht 75 teatro. Nga të cilat 29 teatro profesioniste, 13 teatro profesioniste për fëmijë dhe 33 teatro amatore.

Statusi i teatrove kombëtare Kroate:

- Teatri Kombëtar Kroat në Zagreb,
- Teatri Kombëtar Kroat Ivana pl. Zajca Rijeka,
- Teatri Kombëtar Kroat në Osijek,
- Teatri Kombëtar Kroat në Split,
- Teatri Kombëtar Kroat në Varazhdin.

Të gjitha Teatrot Kombëtare, në aktivitetet e tyre gjenerojnë një program të pasur të të tri skenave artistike teatrore: operë, balet dhe dramë, kurse në Teatrin Kombëtar të Rijekës funksionon edhe drama italiane.

Teatri Kombëtar Kroat i Zagrebit është institucioni më i lartë teatror në Republikën e Kroacisë.

- Themelues është Republika e Kroacisë.

Teatro profesioniste të qyteteve

- Teatri Dubrovnikut "Marin Drzhic"
- Teatri i Qytetit Pozhegë
- Teatri Rinor i Qytetit të Splitit
- Teatri i Qytetit të Pulës
- Teatri i Viroviticës
- Teatri i Dramës "Gavella" i Zagrebit
- Teatri ITD (pronar: Universiteti i Zagrebit)
- Teatri i Qytetit të Zagrebit «Komedija»

Teatrot profesioniste të fëmijëve

- Teatri i fëmijëve i Osijekut
- Teatri i Kukulave i Rijekës

- Teatri i Kukullave i Splitit
- Teatri i Kukullave i qytetit të Zagrebit
- Teatri i Qytetit “Treshnja”, Zagreb
- Teatri i qytetit “Zhar ptica” i Zagrebit
- Teatri i Kukullave të Zagrebit

Përparësitë e ligjit kroat për teatro

Autorët që punuan koncept dokumentin e Ligjit kroat për teatro kanë patur parasysh pikëpamjet nacionale mbi dramaturgjinë nacionale dhe teatrin nacional kroat, gjithënjë duke pretenduar se një teatër kombëtar nuk mund të mbulojë gjithë territorin kroat me krijimtarinë teatrore kombëtare. Mungesa e mbulimit të territorit me vepra kombëtare do hapte mundësinë e komercializimit të teatrove. Komercializimi i teatrove do të nënkuptonte komercializimin e temave për trajtim nga teatrot. Do të mungonte dramaturgjia kombëtare dhe trashëgimia e letërsisë dramatike kombëtare, prandaj:

- Ligji kroat për teatro hapë mundësinë e frymëmarrjes kombëtare në gjithë territorin kroat
- Ligji kroat për teatro mundëson themelimin e teatrove kombëtare në gjithë territorin kroat
- Ligji kroat obligon ministrinë dhe bashkitë për themelimin e teatrove kombëtare
- Ligji kroat obligon qeverinë, përkatësisht ministrinë e kulturës për të ndarë bugjet për teatro kombëtare dhe jo vetëm
- Ligji kroat obligon qeverinë, përkatësisht ministrinë e kulturës të mbulojë me fonde disa nga festivalet prestigjioze teatrore të nivelit kombëtar, me të vetmin qëllim që të nxis dhe motivoj krijuesit letrar dhe teatrore dhe kështu të kontribuoj në zhvillimin dhe forcimin e krijimtarisë kombëtare
- Ligji kroat për teatro përcakton dhe definoi sakt obligimet e udhëheqësve të teatrit, përgjegjësitë e secilit prej tyre dhe pamundëson interferimin e kompetencave në mes tyre
- Ligji kroat për teatro mundëson kontrollin dhe mbikqyrjen e punës së udhëheqësve të teatrit duke kërkuar prej tyre raportim tre mujor me shkrim të këshilli drejtues, dhe këshilli drejtues të ministria e kulturës
- Ligji kroat për teatro sanksionon dhe kërcnon me shkarkim nga puna të udhëheqësve të teatrit nëse raporti nuk miratohet nga ministria
- Ligji pretendon për një sistem më modern të teatrit dhe një organizim të përmirësuar të teatrove kombëtare publike. Pretendimet orientohen në fushën drejtimit të teatrove, precizimin e sistemit të financimit, dhënien e përgjegjësisë më të mëdha në menagjimin e teatrit, si dhe detyrimet për të paraqitur raporte të rregullta mbi programet dhe operacionet financiare. Mënyrën më të detajuar të zgjedhjes dhe emërimit të udhëheqësve të teatrit, mënyrën e detajuar e themelimit të Këshillave Drejtuese të Teatrove, mënyrën e propozimit dhe shkarkimit të Këshillave Drejtuese të Teatrove

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Përmes plotësimit ndryshimit të ligjit aktual për Teatrot, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon të krijojë dhe të zhvillojë politika, ambient dhe mekanizma të përshtatshëm për zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve të kulturës duke stimuluar kështu krijimtarinë institucionale.

Objektivat

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes Departamentit të Kulturës ka për prioritet, krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin bashkëkohor të arteve skenike-muzikore e pamore, artit të shkruar, botimit të librave si dhe promovimin e kulturës me vlera të mirëfillta dhe aftësi konkurruese në vend dhe në arenën ndërkombëtare.

Objektivat e synuara përmes plotësimit/ndryshimit të ligjit aktual janë me sa vijon:

- Avancimin e kornizës ligjore për veprimtarinë institucionale të teatrove publike në Kosovë;
- Adresimin e çështjes lidhur me mangesit e Ligjit aktual për Teatro; dhe
- Zgjidhjen e problemeve të çështjes përmes plotësimit ndryshimit aktual.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni i 1. Status quo (asnjë ndryshim)

Nëse nuk ndryshohet ligji aktual, vazhdon të mbetet situata e njëjtë dhe njëherazi nuk do të adresonte çështje të tilla sikurse përcaktimi i pa-qartë i definimit adekuat i statuseve juridike dhe fiannciar dhe i emertimeve institucionale të teatrove publike të qyteteve, përcaktimi i pa-qartë i kompetencave mes organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë, interferimi në kompetencat mes organeve të udhëheqëse, paqartësia dhe mungesa e përkufizimeve, përcaktimi jo i sakt i obligimeve dhe të drejtave të punonjësve artistik, përcaktimi jo i sakt i numrit të stafit teknik profesional të teatrove, buxheti i paqartë i teatrove publike të qyteteve, përzgjedhja e anëtarëve jo adekuat në keshillat drejtues të teatrove, mungesa e bazes ligjore e cila ju mundëson komunave financimin e tetarove publike të qyteteve si dhe mungesa e kodeve të veqanta buxhetore (PCF 1) të teatrove publike të qyteteve.

Opsioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ndryshimi i politikës ekzistuese do të behet me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit aktual për Teatrot. Plotësim ndryshimin i ligjit aktual të Teatrove paraqitet si nevojë në kuadër të avancimit të kornizës ligjore, prioritetëve të Qeverisë së Kosovës si dhe pajtueshmërisë me standardet dhe praktikat evropiane të fushës.

Plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në politikat aktuale dhe në funksionalizimin e këtyre institucioneve, ku do të definohej/rregullohej/përcaktohej sakt: kompetencat mes organeve udhëheqëse të institucioneve në fjalë duke evituar interferimet e kompetencave në mes organeve të lartçekura, statutet dhe emërtimet e teatrove publike të Kosovës, obligimet dhe të drejtat e punonjësve artistik dhe numrin e tyre, burimet financiare të teatrove publike të qyteteve, kdet buxhetore (PCF 1) e tatrove publike të qyteteve. zgjedhja e anëtarëve adekuat në keshillat drejtues të teatrove si dhe bazen ligjore e cila e rregullon dhe u krijon mundësi ligjore edhe komunave për financimin e tetarove publike të qyteteve;

Gjithashtu ky plotësim/ndryshim i ligjit do të mundësonte njëherazi që politikat në fushën e kulturës të jenë në përputhje dhe në referencë të veprimtarisë shoqërore dhe ekonomike me fokus stimulimin e krijimtarisë kulturore-artistike dhe

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	- Ruajtja e status quos	1. Plotësim/Ndryshimi i Ligjit Nr..për Teatrot	Politika ekzistuese nuk mund të ndryshohet në mënyrë tjetër.
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	- Qytetarët e Republikës së Kosovës	- Qytetarët e Republikës së Kosovës - Teatrot	- Qytetarët e Republikës së Kosovës
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Administrimi ose zbatimi	Ministria e Kulturës, Rinës dhe	Ministria e Kulturës, Rinës	Ministria e Kulturës, Rinës

i programit ose shërbimit	Sportit	dhe Sportit	dhe Sportit
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimimi dhe dënimet	1. Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatort Aktet nënligjore 1.	1. Plotësim/Ndryshimi i Ligjit Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatort	1 Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatort Aktet nënligjore 1.
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat	- Nuk ka ndikime	- Nuk ka ndikime	- Nuk ka ndikime
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	- Nuk ka nevojë fushatë komunikimi.	- Komunikimi për koncept dokumentin është bërë duke zbatuar Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës 09/2011, janë konsultuar institucionet e përcaktuara me këtë rregullore.	- Fushatat e Edukimit dhe komunikimit bëhen sipas planit të paraparë.

Opsioni i 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

1. Nëse ligji nuk plotësohet/ndryshohet dhe vazhdonet me zbatimin e politikës ekzistuese, nuk ka alternativ apo mënyrë tjetër për të rregulluar dhe adresuar çështjet e identifikuar. Mënyra e ndryshuar e zbatimit të legjislacionit nuk ofron zgjidhje të problemit.
2. Për mos përmbushje të obligimit të marrë sigurisht se përgjegjës do të ishte fillimisht MKRS, por edhe Qeveria e Kosovës.
3. Trajnimet dhe programet tjera për qasjen ekzistuese të zbatimit nuk do të kanë efekt në adresimin e problemit. Adresimi i problemit bëhet vetëm me plotësim/ndryshimin e ligjit aktual.

Opsionet tjera:

Nuk ka pas dhe nuk ka nevojë për shqyrtimin e opsioneve tjera, të njëjtat do të ishin jo relevante.

Kapitulli 5. Përmbledhje e opsioneve

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Opsioni i 1 (parë), (status quo): Sipas opsionit 1 përfitime do të jenë vetëm ato që kanë qenë gjer më tani, përkatësisht ato që kanë derivuar nga zbatimi i kornizës aktuale ligjore.
2. Opsioni i 2 (dytë): Përmes këtij opsioni, përkatësisht plotësim/ndryshimit të ligjit aktual do të bëhej qartësimi Së fundmi plotësimi /ndryshimi i ligjit aktual do të kishte impakt të theksuar në zhvillimin dhe profesionalizimin e këtij sektori duke ofruar mundësi dhe zgjidhje më praktike për avancimin e sektorit në fjalë.
3. Opsioni i 3 (tretë): Nëse ligji nuk plotësohet/ndryshohet vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese.

Pasojat negative

1. Opsioni i 1 (parë) - Ndikime negative do të evidentohen kryesisht ato që ndërliohen me mosdefinimin dhe përcaktimin e shumë çështjeve të rëndësishme për sektorin përkatës, mos harmonizim me aktet tjera ligjore që janë në fuqi etj.
2. Opsioni i 2 (dytë). - Nuk ka pasoja negative nëse vendoset sipas këtij opsioni.
3. Opsioni i 3 (tretë). - Vlenë i njëjti përshkrim i pasojave negative si në opsionin e parë.

Efekti shpërndarës

1. Plotësim/ndryshimit i ligjit aktual sjellë përfitime për institucionet qendrore, lokale, shoqërinë civile e para se gjithash qytetarët e vendit.
2. Përfitimet dhe pasojat negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opsionet e konsideruara nuk janë të lidhura me rajone apo pjesë të caktuar të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e vendit.
3. Ndikimet e opsioneve të konsideruara janë të njëjta për të gjitha moshat dhe veprojnë njëjtë në të dy gjinitë, pra nuk ka efekte

dalluese në baza të gjinive apo moshës.

Kosto:

Nga gjitha analizat e bëra propozojmë që për çdo Teatër të krijohet nën kod i veçantë (PCF-1) në kuadër të nen programit për kulturë rini dhe sport në kuadër të Komunës përkatëse. Punëtorët të hyjnë në liste të rregullt dhe të paktën të zhvillohen tri , katër aktivitetet (shfaqje teatrale) në vit. Numri i punëtorëve dhe buxheti i nevojshëm për funksionim e tij është, shih në tabelë:

Teatrot profesioniste neper Komuna	Org. Buxhetore Komunale	Programi per punëtoreset ne ligjin e buxhetit 2019 të jete	Nr. i	Paga dhe Meditje	Malltra dhe sherbime	Shpenzimet komunale	Subvencione dhe transfere	Totali
Teatri profesionist Gjilan	651	850/85027	22	118,800	1,200	3,469	68,500	191,969
Teatri profesionist Gjakove	632	850/85016	22	118,800	1,200	2,990	68,500	191,490
Teatri profesionist Prizren	622	850/85010	22	118,800	1,200	2,008	68,500	190,508
Teatri profesionist Peje	635	850/85019	22	118,800	1,200	3,469	68,500	191,969
Teatri profesionist Ferizaj	656	850/	22	118,800	1,200	2,990	68,500	191,490
Teatri profesionist Mitrovice	642	850/85022	22	118,800	1,200	2,008	68,500	190,508
Totali			132	712,800	7,200	16,934	411,000	1,147,934

Konsultimi me ekspertë, institucionet kulturore, etj.

- Teatri Kombetar i Kosoves;
- Përfaqësuesi i teatrove të qyteteve
- Përfaqësuesit e SKQ-së
- Konsultimi me Ministrinë tjera:.....
- Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile
- Konsultimet kryesisht janë bërë në takimet tona me akterët kryesor të shoqërisë civile dhe ministrin dhe përfaqësuesin e teatrove të qyteteve.

Kapitulli i 7: Krahasimi i opsioneve (vlerësimi i pasojave të secilit opsion)

Opsioni i dytë është plotësim/ndryshimi i ligjit aktual do të ishte opsioni më i qëlluar dhe i rekomanduar për arritjen e synimit dhe objektivave të parapara në pjesën 3.

Kapitulli 8: Rekomandimi

Rekomandohet:

1. Procedurat për plotësimin dhe ndryshimin do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit që të arrihen objektivat e parapara.
2. Brenda tremujorit të parë që nga aprovimi i Koncept Dokumentit në Qeveri duhet të fillojë plotësimi /ndryshimi i ligjit aktual.
3. Nuk do të ketë ndryshime të mëdha në kosto plotësim ndryshimin e ligjit aktual.
4. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit do të formohet ekipi punues për plotësim/ndryshimin e ligjit, i cili do të përcjell informatat e përditësuara lidhur me procesin e hartimit të projektligjit në fjalë.

Kapitulli 09: Komunikimi

1. Akterët kryesorë të fushës janë në dijeni për fillimin e procedurave lidhur me ndryshimin e ligjit aktual. Ata do të jenë të njoftuar për çdo veprim të ri përmes shkresave zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët e prekur do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me akte ligjore dhe nën-ligjore, varësisht nga faza e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

10. Projekt vendimi i Qeverisë

Aprovohet Koncept-Dokumenti i për Teatrot.

Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.